

CILËSIA E JETËS NË PACIENTËT ME KANCER TË PROSTATËS

Ramadan Bara¹, Albana Gjyzari², Armela Bara³

¹*Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Shërbimi i Radioterapisë, Tiranë, Shqipëri*

²*Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Shërbimi i Nefrologjisë, Tiranë, Shqipëri*

³*Universiteti Barleti*

Autori korrespondent: Ramdan Bara, email: radi.bara@hotmail.com

Hyrje: Kanceri i prostatës është sëmundja e dytë më e shpeshtë malinje tek meshkujt.

Qëllimi: Ky studim synoi të vlerësojë shpeshtësinë e çrregullimeve urinare dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetës së pacientëve me kancer të prostatës.

Materiale dhe Metoda: U zhvillua një studim cross-sectional në një spital universitar terciar gjatë periudhës janar 2023 – korrik 2025. U përfshinë 40 meshkuj të diagnostikuar me kancer të prostatës, të trajtuar me prostatektomi radikale, rezeksion transuretral, terapi deprivuese androgjenike dhe radioterapi. Cilësia e jetës u vlerësua me pyetësorët EORTC QLQ-C30 (v3) dhe EORTC QLQ-PR25. U regjistruan të dhënat mbi moshën, komorbiditetet, PSA para trajtimit, rezultatin Gleason dhe dozën e radioterapisë.

Rezultatet: Moshë mesatare ishte 71 ± 6.6 vjeç; 10% ishin në punë në momentin e diagnostikimit. Urinimi i shpeshtë gjatë natës u raportua nga 70.3% e pacientëve, gjatë ditës nga 67.6%, ndërsa urgjenca urinare nga 32.4%. Urinimi i pavullnetshëm u raportua nga 56.8% (herë pas here ose shpesh), dhimbja gjatë urinimit nga 62.2%, dhe hematuria nga 32.4%. Rreth 13.5% kishin vështirësi të shpeshta në aktivitetet ditore, 29.7% ndiheshin të shqetësuar dhe 45.9% kishin gjumë jo cilësor. Cilësia e jetës mesatare ishte 3.7 ± 1.0 . U gjet lidhje statistikisht e rëndësishme midis urinimit të shpeshtë dhe cilësisë më të ulët të jetës ($p=0.014$), si dhe midis urinimit të pavullnetshëm dhe gjumit të dobët ($p=0.02$).

Përfundime: Çrregullimet urinare janë të zakonshme dhe ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve me kancer të prostatës. Menaxhimi i hershëm i këtyre simptomave duhet të jetë pjesë thelbësore e kujdesit onkologjik për përmirësimin e mirëqenies së pacientëve.

Fjalë Kyce: Kancer prostate, Cilësi e jetës, radioterapi, prostatektomi radikale.